

Përmbledhje

Lehtësimi i masave të kontrollit si rezultat i progresit të shënuar në menaxhimin e pandemisë që u shoqërua me vaksinim masiv dhe rënie të shkallës së infeksionit, u reflektua në rigjallërim ekonomik në eurozonë. Në TM2 2021, aktiviteti ekonomik u karakterizua me rritje reale vjetore prej 13.7 përqind, nga rënia e shënuar në tremujorin paraprak prej 1.3 përqind. Tremujori i dytë i vitit 2021 u ndikua pozitivisht edhe nga rritja e kërkesës së jashtme dhe stimujve të konsiderueshëm fiskal. Edhe vendet e rajonit filluan rikuperimin ekonomik, pas goditjes së shkaktuar nga pandemia Covid-19. Në TM1 2021, vlerësimet sugjerojnë se vendet në rajon janë karakterizuar me një rritje mesatare ekonomike prej 0.9 përqind, ndërsa parashikimet e FMN-së për krejt vitin 2021 sugjerojnë rritje të aktivitetit ekonomik prej 5.1 përqind për rajonin.

Edhe ekonomia e Kosovës vlerësohet të ketë rikuperuar aktivitetin ekonomik në gjysmën e parë të vitit 2021, duke i'u atribuar lehtësimit të masave kufizuese si rezultat i përmirësimit të krizës shëndetësore në këtë periudhë. Sipas vlerësimeve të ASK-së, BPV-ja reale në TM1 2021 ka shënuar rritje të përshpejtuar prej 5.6 përqind, rritje që vlerësohet të ketë vazhduar edhe në TM2 2021. Këto vlerësime mbështeten në rritjen e eksportit të mallrave dhe shërbimeve, konsumit dhe investimeve publike, remitencave, si dhe në rritjen e prodhimit industrial dhe të tregtisë me pakicë.

Çmimet e konsumit dhe indekset tjerë të çmimeve kanë shënuar rritje të lartë në gjysmën e parë të vitit 2021. Sidoqoftë rritja e çmimeve rezulton të jetë nxitur nga faktorë të përkohshëm të brendshëm dhe jashtëm që i atribuohen kryesisht efektit të rimëkëmbjes nga kriza pandemike (detaje në kutinë nr. 1).

Rritja e aktivitetit ekonomik në periudhën raportuese është shoqëruar me përmirësimin e performancës së të hyrave buxhetore. Të hyrat buxhetore në TM2 2021 shënuan rritje prej 45.3 përqind, përderisa shpenzimet buxhetore shënuan rënie prej 4.6 përqind, duke bërë që buxheti i Kosovës të regjistrojë suficit primar prej 46.9 milionë euro. Borxhi publik ka vazhduar me rritje dyshifrore vjetore prej 24.3 përqind dhe ka arritur vlerën prej 1.6 miliardë euro, përderisa si përqindje e BPV-së, ka arritur në 23.2 përqind në TM2 2021.

Kundrejtë vitit paraprak, sistemi financiar është zgjeruar me ritëm të përshpejtuar, kryesisht mbështetur nga zhvillimet në sektorin bankar dhe atë pensional. Asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 8.3 miliardë euro në TM2 2021. Në sektorin bankar, aktiviteti u mbështet nga rritja e kreditimit dhe depozitave, përderisa rritja e shënuar në sektorin pensional i'u atribua rritjes së kontributeve të arkëtuara nga kontribut dhënësit dhe kthimit pozitiv në investime.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse është dyfishuar në TM2 2021, kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit të mallrave si dhe rënies së bilancit pozitiv të të ardhurave parësore, ndërkohë që bilanci i shërbimeve dhe i të ardhurave dytësore është përmirësuar. Deficiti tregtar i mallrave ishte 952.0 milionë euro apo 56.6 përqind më i lartë krahasuar me TM2 2020, dinamikë që kryesisht i'u atribuua rritjes së importit, përkundër rritjes së konsiderueshme të eksportit. Në kuadër të bilancit të pagesave, rritje të konsiderueshme në TM2 2021 kanë shënuar edhe remitencat (24.8 përqind) dhe IHD-të (78.8 përqind).

PËRMBAJTJA

Përmbledhje -----	1
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	4
Ekonomia e Kosovës -----	5
Spektori Real -----	5
Kutia 1. Dinamikat e inflacionit gjatë pandemisë COVID-19 dhe përcaktuesit e tij -----	6
Spektori Fiskal -----	9
Spektori Financiar -----	10
Spektori i Jashtëm -----	11

FIGURAT DHE TABELAT


Figura 1. Norma e rritjes së BPV-së dhe inflacionit në Eurozonë -----	04
Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuuesit kryesorë -----	06
Figura 3. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj -----	12
Figura 4. Eksporti dhe importi i mallrave-----	12
Figura 5. Eksporti i mallrave -----	12
Figura 6. Importi i mallrave-----	13
Figura 7. Remitencat -----	14
Figura 8. Struktura e investimeve të huaja direkte -----	14
Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale në Ballkanin Perëndimor -----	05
Tabela 2. Norma vjetore e inflacionit në Ballkanin Perëndimor -----	05
Tabela 3. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	16

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
BQE	Banka Qendrore Evropiane
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
MF	Ministria e Financave dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Përmirësimi i situatës pandemike dhe vaksinimi masiv u shoqëruan me zbutje të masave të kontrollit, duke u reflektuar kështu edhe në rikuperim të aktivitetit ekonomik në eurozonë. Gjithashtu, përforcimi i kërkesës së jashtme dhe pakot stimuluese fiskale u reflektuan në rritje vjetore prej 13.7 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2021, kundrejtë rënies prej 1.3 përqind të shënuar në tremujorin paraprak (figura 1).



Burimi: Eurostat.

Spanja shënoi normën më të lartë të rritjes së aktivitetit ekonomik me 19.8 përqind, pasuar nga Franca dhe Italia, të cilat raportuan rritje të aktivitetit ekonomik prej 18.7 përkatësisht 17.3 përqind, përderisa Gjermania raportoi rritje të aktivitetit ekonomik prej 9.2 përqind. Me zbutjen e masave të kontrollit si dhe rritjes së besueshmërisë së konsumatorëve si rezultat i vaksinimit masiv, në parashikimet e realizuara në qershor të vitit 2021, BQE pret një rikuperim të aktivitetit ekonomik prej 4.6 përqind në vitin 2021.

Norma mesatare e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në TM2 2021 ishte 1.8 përqind (0.2 përqind në TM2 2020). Rritja e çmimeve në Eurozonë, përveç rritjes së kërkesës, i'u atribua edhe faktorëve të përkohshëm të ndërlidhur me pandeminë, siç është rritja e kostos së inputeve si pasojë e ndërprerjes së furnizimit. Duke marr parasysh vlerësimet aktuale për dinamikën dhe perspektivën e inflacionit, që unanimisht po konsiderohen nga bankat qendrore të jenë me karakter të përkohshëm, Këshilli Drejtues i BQE-së vendosi të mbajë të pandryshuar politikën monetare, përderisa kushtet e favorshme të financimit të mbahen me një ritëm mesatarisht më të ulët të blerjeve të aseteve në kuadër të Programit Pandemik të Blerjes së Aseteve. Blerja e aseteve në kuadër të programit, tashmë subjekt i perspektivës së inflacionit, pritet të përfundojë në mars 2022 në vlerë prej 1.85 bilion euro. Për vitin 2021, BQE ka parashikuar normë mesatare të inflacionit prej 2.2 përqind në vitin 2021, normë që pritet të normalizohet në dy vitet vijuese në 1.7 përkatësisht 1.5 përqind në 2022 dhe 2023.

Aktiviteti kreditues dhe depozitues në Eurozonë ka vazhduar të rritet, rritje që është evidentuar si tek ndërmarrjet ashtu edhe tek ekonomitë familjare. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 1.4 përqind në TM2 2021, ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 4.5 përqind. Me rritje të lartë janë karakterizuar depozitat, ku depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 7.9 përqind ndërsa depozitat e ekonomive familjare u rritën për 6.8 përqind.

Edhe vendet e Ballkanit Perëndimor kanë filluar rikuperimin e aktivitetit ekonomik pas goditjes së

shkaktuar nga pandemia Covid-19. Në TM1 2021¹ aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizua me rritje mesatare prej 0.9 përqind. Rritja më e lartë e aktivitetit ekonomik në TM1 2021 është shënuar në Kosovë dhe Shqipëri. Me rritje të aktivitetit ekonomik është karakterizuar edhe Serbia, ndërsa vendet tjera kanë shënuar rënie (tabela 1). Për TM2 2021, vetëm Zyra e Statistikës së Serbisë ka publikuar vlerësimet e BPV-së, të cilat sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në Serbi ka shënuar rritje prej 13.7 përqind, nga 1.8 përqind sa ishte në TM1 2021. Për vitin 2021, parashikimet e FMN-së sugjerojnë se aktivitetit ekonomik në rajon do të shënojë rritje mesatare prej 5.1 përqind.

Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale në B. Perëndimor

Përshkrimi	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4	2021 TM1
Serbia	2.6	2.9	4.9	6.3	5.2	-6.3	-1.4	-1.0	1.8
Mali i Zi	3.2	3.6	5.2	3.7	2.6	-20.3	-26.9	-7.5	-6.4
Kosova	4.3	2.9	6.0	5.6	1.6	-7.1	-6.3	0.8	5.6
Maqedonia e Veriut	1.4	4.3	3.6	3.3	0.9	-14.9	-3.3	-0.7	-1.9
Shqipëria	2.3	2.1	4.2	-0.1	-2.8	-11.3	-3.5	2.4	5.5

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Ngritje e shkallës së inflacionit u raportua edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, si pasojë e rritjes së kërkesës së brendshme dhe rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Norma mesatare e inflacionit në TM2 2021 ishte 2.4 përqind. Serbia regjistroi normën më të lartë të rritjes së inflacionit prej 3.2 përqind, ndërsa Shqipëria regjistroi normë më të ulët krahasuar me vendet tjera (1.8 përqind) (tabela 2).

Tabela 2. Norma vjetore e inflacionit në B. Perëndimor

Përshkrimi	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3	2020 TM4	2021 TM1	2021 TM2
Kosova	3.2	3.3	2.6	1.7	1.1	0.2	-0.4	-0.1	0.6	2.1
Mali i Zi	0.4	0.5	-0.1	1.1	0.5	-1.1	-1.4	-1.3	-0.1	2.3
Maqedonia e Veriut	1.2	1.2	0.6	0.0	0.6	0.5	1.5	2.2	2.0	2.8
Serbia	2.4	2.3	1.3	1.4	1.7	1.0	1.9	1.6	1.4	3.2
Shqipëria	1.6	1.4	1.4	1.3	1.6	1.9	1.4	1.6	0.9	1.8

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, vendet e Ballkanit Perëndimorë shënuan rritje të aktivitetit kreditues prej 7.4 përqind, që është normë e ngjashme krahasuar me TM2 2020. Norma më e lartë e rritjes është shënuar në Kosovë (12.2 përqind), pasuar nga Serbia (7.0 përqind), Mali i Zi (6.8 përqind), Shqipëria (5.9 përqind) dhe Maqedonia e Veriut (5.1 përqind). Depozitat shënuan rritje mesatare prej 10.7 përqind, që është normë më e lartë e rritjes krahasuar me rritjen prej 9.4 përqind në TM2 2020. Edhe tek depozitat, norma më e lartë e rritjes është shënuar në Kosovë dhe Serbi (14.7 përkatësisht 12.1 përqind), pasuar nga Mali i Zi (11.4 përqind), Shqipëria (8.6 përqind) dhe Maqedonia e Veriut (6.8 përqind).

Gjatë TM2 2021, euro është vlerësuar ndaj lirës turke (33.8 përqind), dollarit amerikan (9.6 përqind), frankës zvicerane (3.5 përqind), ndërsa është zhvlerësuar ndaj sterlinës britanike (2.8 përqind), lekut shqiptar (1.2 përqind), kunës kroate (0.6 përqind), etj.


Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Si rezultat lehtësimi të masave kufizuese për ruajtjen e shëndetit të publikut, aktiviteti ekonomik ka shënuar rritje në gjysmën e parë të vitit 2021. Sipas vlerësimeve të ASK-së, BPV-ja reale në TM1 2021 ka shënuar rritje të përsheptuar prej 5.6 përqind. Konsumi dhe investimet kanë kontribuar pozitivisht me 7.5 përkatësisht 4.6 pikë përqindje ndërsa eksportet neto ndikuan negativisht aktivitetin ekonomik me 6.5 pikë përqindje (figura 2).

¹ Të dhënat për TM2 2021 nuk janë publikuar ende.

Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.

Sipas ASK-së, rritja më e lartë e BPV-së në TM1 2021 është shënuar në sektorin e shëndetësisë dhe punës sociale (26.3 përqind), ndërtimitarisë (11.5 përqind), administrimit publik (10.2 përqind), edukimit (9.6 përqind) dhe aktiviteteve financiare dhe të sigurimit (8.9 përqind). Rritje prej 2.3 përqind është shënuar edhe në sektorin e tregtisë, si njëri ndër sektorët me pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej aktivitetin ekonomik. Në anën tjetër, në sektorin e furnizimit me energji elektrike dhe gaz është shënuar rënie prej 9.9 përqind. Rënie e aktivitetit ekonomik është shënuar edhe në sektorin e industrisë nxjerrëse (-5.9 përqind) dhe atë të transportit dhe magazinimit (-3.1 përqind).

Vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se trendi i përshpejtuar i rritjes së aktivitetit ekonomik ka vazhduar edhe në TM2 2021. Këto vlerësime mbështeten në indikator të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që tregojnë për rritjen e eksportit të mallrave dhe shërbimeve në periudhën raportuese, rritjen e konsumit dhe investimeve publike, rritjen e remitencave, etj. Në anën tjetër, rritja shumë e lartë e

importit të mallrave ka ndikuar negativisht rritjen reale të BPV-së në periudhën raportuese.

Rritjen e aktivitetit ekonomik gjatë TM2 2021 e dëshmojnë edhe statistikat afatshkurtra të prodhimit industrial si dhe ato të tregtisë me pakicë. Mesatarja e indeksit të prodhimit industrial ka shënuar rritje prej 30.8 përqind, ku sektori i industrisë përpunuese ka shënuar rritje për 43.6 përqind, sektori i industrisë nxjerrëse 12.7 përqind, etj. Në anën tjetër, mesatarja e indeksit të qarkullimit në tregtinë me pakicë është rritur për 14.4 përqind.

Kutia 1. Dinamikat e inflacionit gjatë pandemisë COVID-19 dhe përcaktuesit e tij


Kriza pandemike është përkthyer në një krizë ekonomike dhe sociale, ku masat e distancimit social dhe rritja e pasigurisë rezultuan në rënie të aktivitetit ekonomik që u shoqërua me tkurrje të investimeve, reduktim të theksuar të eksportit të shërbimeve, si dhe rënie të importit të mallrave dhe shërbimeve. Rënia e shënuar e BPV-së prej 3.0 përqind në vitin 2020 u reflektua në përkeqësim të dinamikave në tregun e punës, zgjerim të deficitit të llogarisë rrjedhëse si dhe rritje të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik.

Si rezultat i këtyre zhvillimeve në ekonomi, edhe norma e inflacionit është karakterizuar me luhajtje të theksuara. Siç shihet në figurën 1, gjatë vitit 2020 norma e inflacionit ka pasur rënie të konsiderueshme (normë negative në muajt e fundit), ndërkohë që viti 2020 u përmbyll me një shkallë mesatare të inflacionit prej 0.2 përqind (2.7 përqind në vitin 2019). Ndryshimi i dinamikave të përgjithshme makroekonomike të brendshme dhe jashtme në vitin 2021 u shoqëruan me rritje të çmimeve të përgjithshme, matur përmes katër indekseve që përpilohen nga ASK.² Deri në korrik 2021, norma mesatare e çmimeve të konsumit arriti

² Indeksi i Çmimeve të Konsumit; Indeksi i Çmimeve të Prodhimit; Indeksi i Çmimeve të Importit; Indeksi i Kostos së Ndërtimit.

në 1.6 përqind, rritje që kryesisht u shënuar tek mjetet e komunikimit (16.2 përqind), pijet alkoolike dhe duhani (3.4 përqind), transporti (2.0 përqind), shërbimet shëndetësore (1.6 përqind), etj. Për rritje të çmimeve tregojnë edhe indeksi i çmimeve të prodhimit, të importit dhe veçanërisht çmimet e ndërtimit. Indeksi i çmimeve të prodhimit ka shënuar rritje mesatare prej 2.8 përqind në gjysmën e parë të vitit 2020, kryesisht për shkak të rritjes së shënuar tek nxjerrja e xehes së metalit (29.7 përqind), energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajr të kondicionuar (5.7 përqind), prodhimi i metaleve (5.0 përqind), etj. Në të njëjtën periudhë, rritje prej 5.1 përqind dëshmon edhe indeksi i çmimeve të importit, rritje e nxitur kryesisht nga çmimet e metaleve bazë (13.7 përqind), produkteve minerale (11.3 përqind), plastika (8.8 përqind), etj.

Figura 1. Inflacioni i përgjithshëm, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Indeksi i koston së ndërtimit në gjysmën e parë të vitit 2021 është rritur për 8.7 përqind, kryesisht si pasojë e rritjes së koston së materialeve prej 12.4 përqind, koston së energjisë prej 5.6 përqind si dhe koston së makinerisë prej 2.8 përqind.

Dinamikat e inflacionit në Kosovë përcaktohen kryesisht nga **kërkesa e brendshme si dhe lëvizjet e inflacionit në eurozonë**. Përderisa vitin e kaluar rënia e kërkesës së brendshme u shoqërua me ngadalësim të rritjes së çmimeve, rimëkëmbja e kërkesës së përgjithshme në vitin 2021 u përkthye edhe në rritje në normës së inflacionit. Përveç kësaj, luhatja e normës së inflacionit gjatë pandemisë mund t'i

atribuohet edhe disa faktorëve të përkohshëm, si rishpërndarja e shpenzimeve si dhe zhvillimet në tregun e punës.

Pandemia ka ndikuar në një **rishpërndarje të shpenzimeve të konsumatorëve në kategori të ndryshme**. Gjatë kohës sa ishin në fuqi masat më të ashpra kufizuese, shpenzimet për turizëm, udhëtime, veshmbathje, etj. ishin pothuajse inekzistente, në kontrast me rritjen e shpenzimeve shëndetësore, artikujve të lidhura me shtëpinë (përfshirë ushqimin dhe pajisjet e nevojshme për të punuar dhe mësuar në shtëpi). Një gjë e tillë është parë nga rënia gjegjësisht rritja e aktivitetit ekonomik në sektorët përkatës gjatë vitit 2020. Më konkretisht, në sektorin e transportit dhe magazinimit është shënuar rënia më e lartë e aktivitetit ekonomik (-22.6 përqind), pasuar nga hotelet dhe restaurantet (-20.4 përqind) si dhe në sektorin e artit, zbavitjes dhe rekreacionit (-16.7 përqind). Në anën tjetër, rritja më e lartë e aktivitetit ekonomik është shënuar në sektorin e shëndetësisë dhe aktiviteteve të punës sociale (18.4 përqind). Lëvizje të ngjashme janë shënuar edhe në shportën e konsumatorit, ku çmimet e transportit shënuan rënie më të lartë (-5.8 përqind), pasuar nga çmimet e rekreacionit dhe kulturës (-0.6 përqind), ndërsa çmimet e shërbimeve shëndetësore si dhe çmimet e ushqimeve shënuan rritje prej 4.7 përqind.

Përcaktues tjetër i dinamikave të inflacionit janë edhe **zhvillimet në tregun e punës**, pasi që një rritje e papunësisë apo zvogëlim i pagave ndikon në rënie e fuqisë blerëse dhe shpenzimeve potenciale të konsumatorëve. Statistikat zyrtare të tregut të punës tregojnë se shkalla mesatare e papunësisë në vitin 2020 ka shënuar një ngritje të lehtë në 25.9 përqind nga 25.7 përqind sa ishte në vitin 2019. Rritja e shkallës së papunësisë është kufizuar nga mbështetja fiskale për firmat dhe punëtorët nga ana e qeverisë por edhe për faktin se bizneset në sektorët e prekur nga kriza pandemike kanë menaxhuar rënie e aktivitetit duke zvogëluar të ardhurat dhe orët e punës, kundrejt

largimit të punëtorëve nga puna. Paga mesatare bruto në Kosovë shënoi rënie prej 2.3 përqind gjatë vitit 2020.

Për shkak të pandemisë që rezultoi në mbyllje dhe reduktimit të aktivitetit të bizneseve, paga bruto në sektorin privat shënoi rënie prej 7.5 përqind ndërkohë që paga bruto në sektorin publik shënoi rritje prej 6.8 përqind, që mund t'i atribuohet pagesave shtesë ndaj sektorëve specifikë më të ekspozuar ndaj virusit.


Meqenëse ekonomia e Kosovës është ekonomi e vogël dhe e hapur ndaj vendeve tjera, **faktorët e jashtëm janë përcaktues i rëndësishëm i dinamikave të inflacionit në vend.** Si pasojë e pandemisë Covid-19, gjatë vitit 2020 është shënuar rënie e çmimeve të importit për 1.9 përqind. Çmimet e produkteve minerale, si dhe çmimet e produkteve të tekstitit shënuan rënien më të lartë (-15.9 përkatësisht -13.8 përqind), ndërsa çmimet e metaleve bazë shënuan rënie prej 2.2 përqind. Në gjysmën e parë të vitit 2021, kur situata me pandeminë Covid-19 filloi të përmirësohet, çmimet e importit shënuan rritje për 5.1 përqind. Rritja më e lartë e çmimeve të importit ka ndodhur tek metalet bazë (13.7 përqind), produktet minerale (11.3 përqind), plastika (8.8 përqind), lëkura (8.8 përqind), si dhe vajrat ushqyese (8.1 përqind).

Ndikimi i faktorëve të jashtëm në dinamikat e inflacionit në Kosovë më mirë mund të shihet nëpërmjet indeksit të çmimeve të komponentëve të tregtueshëm dhe indeksit të çmimeve të komponentëve të patregtueshëm. Siç shihet në figurën 2, lëvizja e çmimeve të përgjithshme në Kosovë është më shumë e përcaktuar nga komponentët e tregtueshëm kundrejt komponentëve të patregtueshëm. Kjo për faktin se pjesa dërmuese e shportës së konsumatorit kosovar përbëhet nga komponentë të tregtueshëm (rreth 82 përqind në vitin 2021), ndërsa pjesa tjetër (kryesisht shërbime) përbëhet nga komponentë të patregtueshëm.

Deri në qershor 2021 çmimet e mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme shënuan rritje prej 1.8 përqind, nga 0.4 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit 2020. Në anën tjetër,

mallrat dhe shërbimet e pa tregtueshme shënuan normë të inflacionit prej 1.0 përqind nga norma prej 1.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2020. Rritja e inflacionit të mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme i atribuohet kryesisht rritjes së çmimeve të importit.

Figura 2. Indekset e komponentëve të tregtueshëm dhe të patregtueshëm




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2021)

Dinamikat e inflacionit në Kosovë përcaktohen edhe nga pjesëmarrja mjaft e lartë e produkteve me lëvizje sezonale të çmimeve, si: ushqimi, pijet alkoolike dhe duhani si dhe energjia. Pjesëmarrja e këtyre kategorive në shportën e konsumatorit kosovar në vitin 2021 është rreth 54.1 përqind (39.9 përqind ushqim dhe pije joalkoolike) dhe ka mbetur pothuajse e pandryshuar gjatë viteve, që është dukshëm më e lartë krahasuar me mesataren e Eurozonës (31.3 përqind) dhe më afër me mesataren e vendeve të rajonit (52.0 përqind). Çmimet e këtyre produkteve kanë determinuar lëvizjen e çmimeve gjatë viteve të kaluara, jo vetëm për shkak të pjesëmarrjes së lartë që e kanë në shportën e konsumatorit por edhe për shkak se lëvizja e këtyre çmimeve ka qenë më e theksuar. Kjo bënë që ndikimi i këtyre kategorive në gjithë lëvizjen e çmimeve në Kosovë të jetë më i lartë se sa në vendet tjera të cilat kanë pjesëmarrje më të ulët të këtyre kategorive në shportën e konsumatorit.

Inflacioni bazë, i cili përjashton kategoritë të cilat karakterizohen me ndryshim më të theksuar të çmimeve, paraqet një pasqyrë më të qartë lidhur me inflacionin në Kosovë. Siç shihet në figurën 3, inflacioni bazë historikisht

ka qenë më i ulët se sa inflacioni i përgjithshëm dhe ka shënuar një lëvizje më të përafërt me lëvizjen e inflacionit të përgjithshëm në Eurozonë.

Figura 3. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, rritja vjetore në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2021)

Në gjysmën e parë të vitit 2021 vërehet një lëvizje e ngjashme e inflacionit të përgjithshëm dhe inflacionit bazë krahas inflacionit në Eurozonë. Pra, inflacioni bazë ishte 1.2 përqind ndërsa inflacioni i përgjithshëm ishte 1.3 përqind (tabela 1), ndërkohë që inflacioni në Eurozonë në gjysmën e parë të vitit 2021 ishte 1.4 përqind.

Tabela 1. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin gjatë TM1 2021

Përshkrimi	Pishtat 2021	Mesatarja vjetore e rritjes, %							
		2015	2016	2017	2018	2019	2020	Qer 2021	
IQ	100.0%	-0.5	0.3	1.5	1.1	2.7	0.2	1.3	
Ndëryesja e IQK-së:									
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	39.9%	0.3	-0.6	1.4	1.8	6.0	1.6	0.1	
Energjia	7.8%	1.6	-2.2	4.5	-2.7	0.1	0.2	-2.0	
Mallrat tjerë	18.3%	3.1	4.0	1.4	0.6	1.4	0.0	0.9	
Shërbimet	34.0%	-5.1	0.3	0.4	0.6	0.6	0.9	3.5	
Inflacioni bazë, përjashtuar:									
Ushqimin dhe pijet joalkoolike	60.1%	-0.2	0.2	0.9	0.5	0.5	-0.5	1.3	
Ushqimin, pijet joalkoolike dhe energjinë	52.4%	-0.8	0.6	0.5	0.7	0.5	-0.5	1.4	
Ushqimin, pijet joalkoolike, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin	46.0%	-1.2	0.1	0.3	0.5	0.3	-0.5	1.2	

Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së

Dinamikat në nivelin e çmimeve nuk pritet të ndryshojnë as në gjysmën e dytë të vitit 2021. Rikuperimi ekonomik i brendshëm dhe presionet inflacioniste nga jashtë priten të përktihen edhe në normën e inflacionit në vend. Për vitin 2021, BQK parashikon se niveli mesatar i inflacionit do të jetë rreth 3.2 përqind, ndërsa në fund të vitit, pra në dhjetor 2021, parashihet që norma e inflacionit të jetë 5.4 përqind. Parashikimet e BQK-së bazohen kryesisht në trend, por edhe në parashikimet për lëvizje të çmimeve tek partnerët tregtar, sidomos në Eurozonë, kur kemi parasysh shkallën e lartë e

korrelacionit të çmimeve në Kosovë dhe atyre në Eurozonë. Edhe bankat komerciale, në anketën e fundit të realizuar në muajin qershor 2021, kanë deklaruar se presin që niveli i inflacionit do të jetë dukshëm më i lartë krahasuar me vitin e kaluar (1.9 përqind). Dinamika të ngjashme të rritjes së çmimeve priten edhe tek partnerët kryesor tregtar. Sipas BQE-së, norma e inflacionit në Eurozonë parashihet të jetë 1.9 përqind në vitin 2021, duke arritur nivelin më të lartë prej 2.6 përqind në TM4 2021, ndërkohë që vendet e rajonit janë duke u ballafaquar me normë edhe më të lartë të rritjes së çmimeve.

Rritja e presioneve inflacioniste në nivel global përgjithsisht pritet të stabilizohet përdërisa nxitësit kryesor të këtyre presioneve këtë vit vlerësohen të jenë me karakter të përkohshëm. Rritja potenciale më e qëndrueshme e inflacionit ose pritjeve të inflacionit do të mund të shoqërohej me shtërngim të politikës monetare dhe shtërngim të kushteve financiare globale, duke peshuar kështu mbi rimëkëmbjen ekonomike vecanërisht në vendet në zhvillim që kanë nevoja më të larta për financim të jashtëm.

Në Kosovë, rritja e shkallës së inflacionit në vitin 2021, shoqëruar edhe me zvogëlim të pagës mesatare, jap indikacion për rënie potenciale të fuqisë blerëse, duke pasur më pas efekt potencial zingjiror edhe tek bizneset. Parashikimet e BQE-së për rënie të shkallës së inflacionit në dy vitet vijuese jap sinjale pozitive për vazhdimësinë në procesin e rimëkëmbjes së përgjithshme nga efektet e pandemisë.

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore³ në gjysmën e parë të vitit 2021 shënuan rritje prej 29.2 përqind ndërsa shpenzimet buxhetore⁴ shënuan rritje prej 10.3 përqind. Vetëm në TM2 2021, të hyrat buxhetore arritën vlerën neto 527.6 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 45.3 përqind, përderisa shpenzimet buxhetore në këtë tremujor shënuan rënie prej 4.6 përqind dhe arritën vlerën 480.7 milionë euro. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi suficit primar buxhetor prej 46.9 milionë euro gjatë këtij tremujori.

Rikuperimi i aktivitetit ekonomik rezultoi në ndikuar në një rritje të konsiderueshme të të hyrave tatimore direkte prej 63.0 përqind në TM2 2021. Tatimi në të ardhurat personale, si kategoria kryesore e të hyrave tatimore direkte, shënoi rritje prej 37.3 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rritje prej 80.9 përqind. Me rritjen e kërkesës së brendshme, e cila ka ndikuar në rritjen e importit të mallrave, është shënuar rritje prej 44.0 përqind edhe në të hyrat tatimore indirekte, të cilat dominojnë të hyrat buxhetore me rreth 75 përqind. Në TM2 2021, të hyrat tatimore indirekte shënuan vlerën prej 395.9 milionë euro, ku TVSH-ja dhe akciza si dy kategoritë kryesore të tatimeve indirekte shënuan rritje prej 54.9 përkatësisht 26.9 përqind.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore, kategoria kryesore që kontribuoi në zvogëlimin e shpenzimeve buxhetore gjatë TM2 2021 ishte ajo e subvencioneve dhe transfereve, e cila arriti vlerën prej 167.6 milionë euro apo 18.0 përqind më pak krahasuar me TM2 2020. Edhe shpenzimet për paga shënuan rënie të lehtë prej

2.6 përqind dhe arritën vlerën prej 167.3 milionë euro, ndërsa shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje prej 17.8 përqind dhe arritën vlerën 74.7 milionë euro. Shpenzimet kapitale në TM2 2021 arritën vlerën prej 71.1 milionë euro apo 10.8 përqind më shumë krahasuar me TM2 2020.

Borxhi publik në TM2 2021 ka arritur në 1.6 miliardë euro, që është për 24.3 përqind më i lartë krahasuar me TM2 2020. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 23.2 përqind, nga 18.2 përqind sa ishte në TM2 2020. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 20.0 përqind (që ka arritur në 1.06 miliardë euro), si dhe rritjes së borxhit të jashtëm publik për 33.1 përqind (që ka arritur në 571.6 milionë euro). Pragu i borxhit publik i paraparë me ligj në Kosovë është 40 përqind e BPV-së, rrjedhimisht niveli i borxhit publik prej 23.2 përqind e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit. Sidoqoftë, ky nivel i ulët i borxhit publik mund të rritet shpejt në të ardhmen si rezultat ndikimeve negative të pandemisë Covid-19 në ekonominë e Kosovës dhe planeve të qeverisë për ta financuar deficitin buxhetor nëpërmjet borxhit publik.

³ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen pranimet nga financimi.

⁴ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim.

Sektori Financiar⁵

Asetet e sistemit financiar në qershor 2021 arritën vlerën në 8.31 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.2 përqind. Edhe në baza tremujore, sistemi financiar u zgjerua, kryesisht prej sektorit bankar (depozitave) dhe atij pensional (kontributeve të arkëtuara dhe kthimit prej investimeve). Edhe sektorët tjerë kishin kontribut pozitiv në rritje, por në nivel të ulët si rezultat i peshës së vogël në sistemin financiar.

Në baza tremujore, aktiviteti i sektorit bankar në kuadër të aseteve u mbështet nga rritja e kreditimit, përderisa zërat tjerë bilancor shënuan rënie (bilanci me bankat komerciale, investimet në letrat me vlerë, dhe paraja e mbajtur në bankat komerciale). Kurse, në kuadër të detyrimeve, depozitat shënuan rritjen më të theksuar në këtë tremujor (kryesisht prej depozitave të arkëtuara nga ekonomitë familjare) dhe ekuiteti (fitimi i realizuar).

Treguesit që matin shëndetin e sektorit bankar sugjerojnë se në fund të TM2 2021 sektori bankar shënoi përmirësim të nivelit të likuiditetit, kapitalizimit, profitabilitetit si dhe me cilësi më të lartë të portfolios kreditore.

Sektori pensional u karakterizua me dinamika pozitive si në asetet e përgjithshme ashtu edhe në performancën e investimeve në TM2 2021. Rritja e kontributeve të arkëtuara gjatë kësaj periudhe si dhe kthimi pozitiv nga investimet kontribuan në rritjen e aseteve të sektorit, përkundër ndikimit që kishte tërheqja e 10 përqind të mjeteve nga kontribut-

dhënësit, mundësi e cila u mbyll në fillim të këtij tremujori.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2021, me rritje u karakterizuan edhe asetet e sektorit të sigurimeve. Gjithashtu, rritje të përshpejtuar shënuan primet e shkruara bruto kundrejt dëmeve të ndodhura, e që rezultoi në performancë pozitive të sektorit në këtë tremujor.

Krahasuar me vitin e kaluar, sektori mikrofinanciar shënoi përshpejtim të aktivitetit kreditor, i përkthyer në përshpejtim të rritjes së aseteve në baza tremujore. Gjithashtu, sektori mbylli tremujorin e dytë me rezultat pozitiv financiar dhe nivel të kënaqshëm të cilësisë së portfolios kreditore bazuar në nivelin e ulët të kredive jo-performuese.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2021, Qeveria e Kosovës emtoi borxh në vlerë prej 100.0 milionë euro, përmes fletë obligacioneve me maturitet prej 3 deri në 10 vite. Edhe në ankandet gjatë këtij tremujori kërkesa për të investuar në fletë-obligacione qeveritare tejkaloj ofertën për 1.46 herë.


Sektori i Jashtëm

Kanali kryesor përmes të cilit është transmetuar kriza ekonomike dhe sociale e nxitur nga pandemia Covid-19 në Kosovë ka qenë sektori i jashtëm i ekonomisë. Deficiti i llogarisë rrjedhëse, i cili në vitin 2020 është rritur për 20.4 përqind, ka vazhduar me një trend të përshpejtuar edhe në vitin 2021. Vetëm në TM2 2021, deficiti i llogarisë rrjedhëse është dyfishuar nga 144.8

⁵ Për më shumë informata rreth zhvillimeve në sektorin financiar referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiarë (TM1 2021) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

milionë euro sa ishte në TM2 2020 në 295.5 milionë euro në TM2 2021.


Figura 3. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj, në milionë euro



Burimi: BQK.

Kjo rritje e deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së deficitit të mallrave si dhe rënies së bilancit pozitiv të të ardhurave parësore, ndërkohë që bilanci i shërbimeve dhe i të ardhurave dytësore është përmirësuar (figura 3).

Figura 4. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK.

Eksporti⁶ i mallrave vetëm në TM2 2021 ka shënuar rritje për 64.7 përqind ndërsa importi i mallrave është rritur për 57.9 përqind. Përkundër normës më të lartë të rritjes së eksporteve, niveli dukshëm më i lartë i

importit të mallrave ka ndikuar që deficitin tregtar i mallrave të rritet për 56.6 përqind duke arritur nivelin prej 952.0 milionë euro (figura 4).

Vlera e eksportit të mallrave gjatë TM2 2021 ishte 191.1 milionë euro dhe pothuajse të gjitha kategoritë e eksportit shënuan rritje, ndërsa rritja më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, është shënuar tek metalet bazë, produktet e plastikës dhe gomës, produktet minerale, etj. (figura 5).

Figura 5. Eksporti i mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK.

Rreth 36 përqind e mallrave të eksportuara përbëhet nga produktet e metaleve bazë dhe ndryshimet në çmimet e metaleve në tregjet ndërkombëtare reflektojnë në vlerën nominale të eksporteve. Çmimet e metaleve bazë në TM2 2021 shënuan rritje prej 68.3 përqind dhe kjo ka ndikuar në rritjen e eksportit të metaleve prej 37.2 përqind. Gjithashtu, edhe indeksi i çmimeve të mineraleve në tregjet ndërkombëtare por edhe ai i çmimeve të ushqimit ka shënuar rritje prej 68.3 përkatësisht 41.6 përqind ndërkohë që rritja e eksportit të mineraleve dhe ushqimeve të përgatitura ishte 123.6 përkatësisht 38.0 përqind në TM2 2021.

⁶ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Vendet e BE-së dhe vendet anëtare të CEFTA-s vazhdojnë të përfaqësojnë partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës për eksporte, me pjesëmarrje prej 33.3 përkatësisht 39.1 përqind të gjithsej eksporteve në TM2 2021. Eksportet drejt vendeve të BE-së vetëm në TM2 2021 ishin 64.0 milionë euro duke shënuar rritje prej 40.1 përqind ndërsa eksporti i mallrave në vendet e CEFTA-s ishte 74.9 milionë euro apo 35.9 përqind më shumë krahasuar me TM2 2020. Eksportet drejt SHBA-së po tregojnë një trend rritës mjaft të lartë. Në TM2 2021 pjesëmarrja e SHBA-ve në gjithsej eksportin e mallrave ishte 12.9 përqind nga vetëm 2.6 përqind sa ishte në TM2 2020.

Vlera e importit të mallrave gjatë TM2 2021 ishte 1.1 miliardë euro, që paraqet rritje prej 57.9 përqind. Sikurse tek eksporti i mallrave, edhe rritja e lartë e importit të mallrave, përveç rritjes së kërkesës vendore, mund të shpjegohet edhe nga rritja e lartë e çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Figura 6. Importi i mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK.

Pothuajse të gjitha kategoritë e importit kanë shënuar rritje, ndërkohë që rritjen më të lartë e ka shënuar importi i produkteve minerale (përfshihet edhe importi i derivateve të naftës), pastaj metalet bazë, mjetet e

transportit, si dhe makineritë dhe pajisjet elektrike (figura 6).

Mesatarja e çmimeve të naftës së papërpunuar është rritur për 121.3 përqind në TM2 2021, ndërkohë që importi i produkteve materiale, si njëra ndër kategoritë kryesore të importit të mallrave, është rritur për 108.6 përqind.


Sa i përket strukturës së importeve sipas partnerëve tregtarë, vendet e BE-së dhe vendet anëtare të CEFTA-s përbëjnë vendet prej nga Kosova importon pjesën më të madhe të mallrave. Në TM2 2021, Kosova importoi rreth 44.6 përqind të gjithsej importeve nga vendet e BE-së apo 53.3 përqind më shumë krahasuar me TM2 2020, si dhe 20.4 përqind të gjithsej importeve nga vendet e CEFTA-s apo 54.7 përqind më shumë krahasuar me TM2 2020. Një pjesë e madhe e importit të mallrave është realizuar edhe nga Turqia dhe Kina. Importi i mallrave nga Turqia ishte rreth 13.3 përqind e gjithsej importit apo 63.4 përqind më shumë krahasuar me TM2 2020, ndërsa importi i mallrave nga Kina, kishte një pjesëmarrje prej 8.9 përqind në gjithsej importin e mallrave apo 54.3 përqind më shumë krahasuar me TM2 2020.

Në kuadër të bilancit të pagesave, tregtia me shërbime pësoi rënien më të madhe gjatë vitit 2020 si pasojë e drejtpërdrejtë e masave kufizuese të ndërmarra për të menaxhuar me krizën shëndetësore. Me zbutjen dhe eliminimin e masave kufizuese edhe tregtia me shërbime ka filluar të normalizohet. Në TM2 2021, bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 137.6 milionë euro nga 7.7 milionë euro sa ishte në TM2 2020.

Vlera e eksportit të shërbimeve shënoi vlerën prej 332.1 milionë euro, nga 114.6 milionë euro sa ishte në TM2 2020.

Rritjen më të lartë e shënuar eksporti i shërbimeve të udhëtimit, transportit, ndërtimit, etj. Edhe importi i shërbimeve ka shënuar rritje në TM2 2021, ku vlera e shërbimeve të importuara ishte 194.5 milionë euro (106.8 milionë euro në TM2 2020). Rritja më e lartë është shënuar tek importi i shërbimeve të udhëtimit, transportit si dhe shërbimeve pensionale dhe të sigurimit. Vlen të përmendet se eksporti dhe importi i shërbimeve ishte më i lartë edhe krahasuar me TM2 2019 për 9.0 përkatësisht 16.5 përqind.

Figura 7. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK.

Llogaria e të ardhurave parësore shënoi rënie për 49.7 përqind në TM2 2021, kryesisht si rezultat i të ardhurave nga investimet, ndërkohë që edhe të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve shënuan rënie. Bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 15.3 përqind, kryesisht si rezultat i nivelit më të lartë të remitencave. Norma e lartë e rritjes së remitencave në vitin 2020, përkundër situatës së vështirë të krijuar nga pandemia Covid-19, ka vazhduar edhe në vitin 2021 me trend të përshpejtuar të rritjes. Vetëm në TM2 2021, niveli i remitencave ishte 309.0 milionë euro apo 24.8 përqind më shumë krahasuar me TM2 2020 (figura 7).

Sa i përket kanaleve të transferimit, pjesa dërmuese e remitencave (62.0 përqind) kanë ardhur përmes agjencive për transferim të mjeteve të cilat shënuan rënie prej 3.7 përqind. Meqenëse vitin e kaluar, sidomos në TM2 dhe TM3, kishte mbyllje të kufijve, edhe vlera e remitencave përmes

kanalit 'jo-formal' ishte reduktuar në minimum. Me hapjen e kufijve edhe remitencat përmes kanalit 'jo-formal' janë rritur dhe kanë arritur nivelin prej 73.8 milionë euro vetëm në TM2 2021 nga 11.3 milionë euro sa ishin në TM2 2020. Remitencat përmes bankave shënuan rritje prej 18.6 përqind dhe përbëjnë 14.1 përqind të gjithsej remitencave të dërguara në TM2 2021. Remitencat në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat u dërguan 39.5 përkatësisht 17.3 përqind e gjithsej remitencave. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të (7.0 përqind e gjithsej remitencave).

Figura 8. Struktura e investimeve të huaja direkte, në milionë euro



Burimi: BQK.

Investimet e Huaja Direkte (IHD), në TM2 2021, arritën vlerën prej 123.5 milionë euro, që paraqet rritje prej 78.8 përqind. Rritja e lartë e IHD-ve kryesisht i atribuohet rigjallërimit ekonomik, që u përkthye në rritje më të lartë të fitimit të ri-inestuar si dhe rritje të huamarrjes. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione arriti në 106.1 milionë euro, ndërsa instrumentet e borxhit arritën në 17.4 milionë euro (figura 8).

Rritja e IHD-ve u evidentua kryesisht në sektorin e patundshmërive, informacionit dhe komunikimit, furnizimit me energji elektrike, etj. ndërsa në sektorin e xehtarisë dhe guroreve, tregtisë, prodhimit, etj. është shënuar rënie e IHD-ve.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2021): Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike nr. 35, TM2 2021, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK (2021):

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandevë për letra me vlerë të qeverisë: [Letrat me Vlerë të Qeverisë | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)

ASK (2021):

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-harmonizuar-i-cmimeve-te-konsumit-ihck-qershor-2021>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-icp-tm2-2021>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-cmimeve-te-importit-icimp-tm2-2021>
- d) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/repertori-statistikor-mbi-ndermarrjet-ekonomike-ne-kosove-tm2-2021>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-qershor-2021>

IMF (2021): World Economic Outlook: [World Economic Outlook \(imf.org\)](http://imf.org)

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Qershor 2020	Qershor 2021
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)*	1,409.9	1,492.6
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	0.6%	1.3%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	0.1%	2.4%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	760.3	982.5
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	877.5	968.3
Bilanci primar (në milionë euro)	-117.2	14.2
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	7,406.9	8,309.2
prej të cilave: Bankat	4,849.0	5,568.9
Kredi	3,127.4	3,510.1
Depozita	3,903.2	4,477.8
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	6.26%	6.00%
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	1.54%	1.27%
Hendeku i normës së interesit	4.7%	4.7%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-217.3	-449.6
prej të cilave: remitencat e pranuar	434.9	552.0
Llogaria financiare	-311.8	-256.9
Investimet e huaj direkte në Kosovë	173.5	230.1
Investimet portfolio, net	-389.1	42.1
Investimet tjera, net	195.5	-132.2
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-592.2	-887.4
Asetet	5,054.3	5,348.4
Detyrimet	5,646.6	6,235.8
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,206.9	2,513.8
Borxhi i jashtëm privat	1,717.5	1,907.3
Borxhi i jashtëm publik	489.4	606.5

Burimi:

1/ ASK (2021);

2/ MF (2021);

3/ BQK (2021).

*Të dhënat për BPV, PNI dhe borxh të jashtëm janë deri në mars 2021.

